



Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur më datë, **20.12.2024 (e premte)**, me fillim në orën **10:00**.

Mbledhjen e **pestë** e kryesoi zëvendëskryesuesi, **Lirizon Kastrati**.

Për këtë mbledhje, u propozua ky rend dite:

REND DITE

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vizitë në Qendrën për Punës Sociale në Rahovec;**
- 3. Vizitë në Shtëpinë e të Moshuarve në Rahovec;**
- 4. Të ndryshme.**

Lirizon Kastrati (zëvendëskryesues): Atëherë, përshëndetje për të gjithë! Kjo është mbledhja e pestë e komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2024. Nëse jeni të pajtimit, propozoj që më 30 dhjetor ta mbajmë edhe një mbledhje të komitetit, që në tërë vitin 2024 t'i kemi 6 mbledhje.

Shukrije Himaj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë do të ishte që kjo të jetë mbledhja e fundit për këtë vit, sepse më 30 dhjetor është fundvit dhe jemi me punë të tjera.

Zana Omega: Përshëndetje, gjithashtu edhe unë mendoj njëjtë. Në fund të muajit jemi me angazhime të tjera.

Lirizon Kastrati (zëvendëskryesues): Atëherë, nëse jemi të pajtimit kështu, e bëjmë ashtu siç dëshironi. Pas leximit të rendit të ditës, po e vendosim në votim rendin e ditës si të tillë. Kush është “pro”?... Me vota unanime (4 vota pro) miratohet rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Lirizon Kastrati (zëvendëskryesues): A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Me shumicë unanime (3 vota pro) aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Vizitë në Qendrën për Punës Sociale në Rahovec:

3. Vizitë në Shtëpinë e të Moshuarve në Rahovec:

Lirizon Kastrati (zëvendëskryesues): Si pikë të dytë edhe të tretë i kemi dy vizita. Sot kemi planifikuar që ta vizitojmë QPS-në dhe shtëpinë e të moshuarve te Maja e Shkodranit. Nëse nuk keni diçka për të thënë, pas pak do të nisemi për vizitë.

4. Të ndryshme:

Lirizon Kastrati (zëvendëskryesues): Atëherë, jemi te pika e fundit, nëse dikush ka diçka për të shtuar? Nëse jo, unë në rolin e zëvendëskryesuesit sot dhe si anëtarë i këtij komiteti, ju falënderoj të gjithëve për angazhimin e bërë. E falënderoj sekretarinë e kuvendit, Skenderin dhe Albionin për bashkëpunimin e ngushtë me ne. E falënderoj zyrën për informim, Blertën dhe Dafinën. Vazhdojmë me realizimin e vizitave.

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes;

Vlora Vuçiterna - Çmega

